

Tregime FADIL ZEÇIRI

8SH-32
Z 48

ME
VËSHTRIM
NGA
DETI

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

891.983-32

7 48

S

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

FADIL ZEQRIRI

ME VËSHTRIM
NGA DETI 3/30

(Tregime)

[Handwritten signature]

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
GJURËNASIËT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Piktor: VLASH DROBONIKU

Tirazhi 8000 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204-65

Shtyp NISH shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1969

AMANETI I DETARIT ULQINAK

Babë e bir rrinin afër njëri-tjetrit te timoni. Anija ishte bërë gati për rrugë të gjatë. Velat sapo qenë ngritur. Hambarët qenë mbushur me qymyr druri. Sa punë qe harxhuar për të. U prenë drurë pa numër në pyjet e Rodonit. U hapën gropat e furrave dhe u vendosën drutë e prera. U ndezën ato dhe u mbuluan me dhe. U deshën disa ditë që të digjeshin ngadalë, ashtu me oksigjen të paktë, derisa u shndërruan në qymyr. Qenë ditë vjeshte dhe dimri po afrohej me vrap. Qymyri i drurit kushtonte shtrenjtë në portet e mëdha të Mesdheut.

Shpendi, me një bindje të fortë në vetëvete, rrinte para tet, Saliut, dhe priste që t'i jepte leje për t'u nisur për në Aleksandri. I biri nuk kishte vënë ende brisk në faqe; e shikonte të atin në fytyrë, si për t'i thënë: «Mos

u pikëllo, se anijen e lë në duar të sigurta. Tani unë jam burrë dhe duhet të kesh më shumë besim. Ti vetë ma dhe fjalën të më lëshoje timonin këtë rrugë...»

Plaku, i rrahur nga dallgët e detit dhe ato të jetës, pikëllohej me të drejtë. Ishte hera e parë që Shpendi do ta bënte i vetëm atë rrugë të gjatë, atë rrugë plot rreziqe, ku piratët vinin rrotull si peshkaqenë të uritur. Përveç kësaj, anijet turke të patrullimit e ruanin shumë gjithë bregdetin Adriatik, bregdetin Jon dhe atë të Egjeut. Prandaj plaku rrinte i ngrysur aty, në gjiun e Rodonit, ku dallgët e detit, si ato të zemrës së tij, godisnin në gërmadhat e kështjellës së vjetër me zemërim.

— Çfarë don me të sjellë prej vëndeve të largëta, babë? Ky asht lundrimi im i parë i vetëm, si kapedan i anijes.

Saliu mbushi llullën me duhan të fortë dhe, pasi goditi disa herë eshkën e vënë mbi një strall, e ndezi. Pastaj e treti vështrimin nga Malësia e Madhe. Gjithë atë anë e kishte mbuluar një mjegull e dendur. Edhe drejt detit, në jug, mjegulla mbulonte valët e zbardhura, si për të mbrojtur anijen që nisej për një detyrë të rëndësishme.

— Asgja, bir, asgja, vetëm ki kujdes ta shesësh sa ma shtrenjt qymyrin, që të blesh



sa ma shumë armë. Me marinarët dhe me detin mos u sill mendjemadh. Përpiqu t'u shmangesh turqve dhe piratëve. Mos harro Ulqinin tonë dhe këto troje që presin armë nga ti, — tha plaku dhe e ngriti dorën drejt pyjeve të panumërta që mbulonin hapësirën pas malit të Rodonit. — Veta kthehem sonde në Ulqin me barkën e Arbenit. Në shtëpi do të merrena me rritjen e pulave.

— Të pulave! — u çudit Shpendi.

— Po, të pulave, prandaj copat e bukës që do t'ju mbeten mos i flak, po rueji dhe m'i sill kur të kthehesh. Sillmë një arkë ose dy me kore buke të thata, të ushqej pulat ose më pak, po sillmë.

Djalit i erdhi çudi, po nuk mund t'ja prishte tet tani në pleqëri.

— Mirë, babë, e the ti, u ba. Do t'i ruej copat e bukës.

Babë e bir u përqaftuan dhe u ndanë. Duke dalë nga anija, plaku ndjeu një boshllëk të madh, siç ndjen njeriu, kur, pa dashjen e tij, e nxjerrin nga radhët e luftës. Po kur u mendua, u qetësua pak se, fundi, anijen e tij e linte në duar të sigurta të të birit dhe të detarëve besnikë e të sprovuar. Detarët e tjerë, që kishin bërë me të me dhjetëra rrugë të vështira dhe plot rreziqe nëpër detin Mesdhe,

e shoqëruan me vështrimet e tyre të ngrohta.

— Hajde, me det të mbarë, bir! — thirri plaku nga bregu.

— Mirë të gjeça, babë, — ju përgjegj ai.

— Kujdes për amanetin dhe ruej armët!

— Mos ki merak, babë, the ti, asht e bame.

Teksa bëhej ky muhabet, nisën të shushurisin dallgët dhe fletët e lisave të afërt. Nisi era e veriut, ajo që duhej. Tani anija me vela do të shtyhej drejt jugut si vozë vere bosh. Shpendit ju duk sikur Ulqini atje lart po merrte frymë me zor e kjo erë që do ta shtynte drejt jugut, ishte fryma e qytetit të tij të dashur, po të robëruar.

— Të ngrihen velat, ngrini spirancën! — u dëgjua zëri i kapitenit të ri. Afër i rrinte Ndreka, bocmani, një detar i vjetër dhe mik i të atit. Mustaqet e gjata dhe të trasha si halë peshku nuk i shtriheshin kurrë si të tjerëve. Nga mjekra e gjatë dhe e zezë i vareshin disa pika uji që kishte pirë nga bucela e madhe. Ndreka kishte zbritur në Ulqin nga zonat mallore të pushtuara prej turqve. Kishte ndarë më dysh dy oficerë turq me shpatën e tij, se i kishin rënë në qafë familjes, prandaj qe larguar nga trojet e lindjes dhe kishte ardhur në Ulqin, ku ishte bërë marinar, me qëllim që të

humbte gjurmët dhe të përgatitej për një hakmarrje edhe më të madhe.

Anija u nda nga bregu. Mori kursin në fillim për në det të hapur, pastaj u kthye drejt jugut. Selimi tundte ende shaminë në breg. Atë e shihte i biri vetëm me ndihmën e monoklit zmadhues. Sakaq era, si një dorë e çuditshme, përhapri dalëngadalë mjegullën e velat e anijes zbardhnin qartë tej. Me kalimin e kohës kjo bardhësi u shkri me atë të shkumës së dallgëve. Anija u zhduk në horizontin e kaltër.

Këto rrugë të vështira detarët ulqinakë i bënë me anijet e shpejta të shumtën e herëve pa busullë, duke u orientuar herë me lindjen dhe perëndimin e diellit herë me yllin polar dhe herë me ndihmën e drejtimit të zogjve shtegëtarë. Edhe në anijen e Saliut ishte prishur busulla, një busullë e vjetër. Kështu, detarit të ri i duhej të orientohej drejt qytetit të largët me ndihmën e këtyre objekteve.

— 2 —

Detarët shqiptarë arritën në Aleksandri shëndoshë e mirë, bënë një tregëti me leverdi dhe, si e mbushën anijen me pushkë, barut

dhe stofë muarën rrugën e kthimit për në atdhe.

Afër timonit rrihin Shpendi me Ndrekën. Përpara shtrihej deti i gjerë dhe i paanë. Befas Shpendi hoqi monoklin nga syri dhe i bërtiti shokut:

— Kqyr prapa, po na ndjekin piratët!

Ndreka i rrëmbeu tubin optik dhe e vuuri menjëherë në sy. Sytë e sprovuar ndër lundrime e dalluan menjëherë flamurin e piratëve: i zi me kafkën e të vdekurit në mes. Shtrëngoi fort instrumentin dhe pëshpëriti nëpër dhëmbë:

— Piratët! — Po të binin në dorë të tyre, do të shiteshin si sklevër dhe do t'u merrrej pa kurrfarë shpërblimi e gjithë ngarkesa, duke përfshirë dhe armët e shumëdëshëruara. Anija pirate po afrohej. Ajo dukej e madhe me ato velat e saj të zeza si vetë njerëzit që e drejtonin.

— Ndrekë!

— Urdhëro, kapedan!

— Ngrini dhe velën e fundit. U thuej marinarëve të mbushin pushkët me barut dhe t'i mbajnë pranë rremave. Krahas erës duhet vozitë dhe me rrema. Ne duhet të ecim ma shpejt se ata. Mos harro se piratët kanë edhe topa me vedi. Ne nuk na e don puna të hyjmë